



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

<b>Drejtoria</b>	Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve
<b>Periudha raportuese</b>	Muaji Dhjetor 2023
<b>Emri dhe mbiemri i raportuesit</b>	Znj. Donika Çetta Drejtoreshë e Drejtorisë së Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve

**1. PËRMBLEDHJE** - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve ka vazhduar përgjatë muajit Dhjetor, realizimin e detyrave të caktuara në bazë të planit të punës për rekultivimin e hapësirave të gjelbërta si dhe krijimin e hapësirave të reja të gjelbërta dhe parqeve në Komunën e Prishtinës.

**2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA** - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit dhe fushës së veprimit të Komunës për drejtorinë e Parqeve:

- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana e NPL “Hortikultura”, dhe kujdesi ndaj zonave të gjelbërta brenda territorit të Komunës së Prishtinës; krasitja e drunjëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre;
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave të parqeve për aktivitete;
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e Qendrës Rekreative “Gërmia” për aktivitete sensibilizuese dhe edukuese;
- Pranimi i kërkesave dhe ankesave nga qytetarët, shqyrtimi i tyre edhe nga subjektet tjera komunale dhe dërgimi i tyre për personin apo subjektin që i dedikohen;

### **3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA:**

- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPL “Hortikultura”, krasitja e drunjëve dhe prerja e drunjëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre dhe pune të tjera të mirëmbajtjes dhe pastrimit të hapësirave të gjelbërta;
- Krasitja e degëve të drunjëve të cilat paraqesin probleme pas pranimit të kërkesave nga qytetarët.
- Mbjellja e drunjeve në hapësirat e gjelbërta afër ndërtesës së Qeverisë (Te Soma) etj.
- Vlerësim i tenderit për projektin “Ndertimi i Parkut në Kalabri – Faza e II-te”

### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR -**

- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet dhe mbjelljen e tyre nga ana e NPL “Hortikultura”;
- Identifikimi i hapësirave publike për rigjenerim të tyre përmes projekteve;
- Përmirësimi i infrastrukturës në parqet ekzistuese;

### **5. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim të sipër**

Numri i lëndëve të pranuar: 9

Numri i lëndëve të kryera: 39

Numri i lëndëve të refuzuara: 0

Numri i lëndëve të ceduara: 0

Numri i lëndëve në proces: 1

### **6. Takime të tjera:**

- Takim me Raiffeisen Bank Kosova ( rreth donacionit të dhënë)

### **7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES –**

- Plani i veprimit për vitin kalendarik 2024